



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**  
**BORDI I AKREDITIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 65, datë 21.09.2017**

**PËR**  
**AKREDITIMIN E PARË TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË**  
**UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË**

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”,

si dhe

në zbatim të Kontratës së Përgjithshme të Projektit “Për ofrimin e ekspertizës për Sigurimin e Cilësisë në mbështetje të krijimit të materialeve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, trajnimit të ekspertëve vlerësues të jashtëm dhe ekspertizës në mbështetje të vlerësimit të jashtëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri”, Nr. 2064 Prot., datë 29.02.2016, lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Garantimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar,

në mbledhjen e tij të datës 21.09.2017, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin institucional të **Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, me të dhënat si më poshtë:**

- a) Emërtimi i Institucionit të Arsimit të Lartë: **Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**
- b) Organizimi i Institucionit: **Publik**
- c) Lloji i Institucionit: **Universitet**
- d) Njësitë kryesore të Institucionit:
  - a. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

- b. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
  - c. Fakulteti i Ekonomisë
  - d. Fakulteti i Bujqësisë
- e) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 5, datë 07.01.1992

**pasi mori në shqyrtim:**

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e përgjithshme institucionale, Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- b. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- c. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e Agjencisë Britanike dhe atyre vendas në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- d. Dobësitë e evidentuara dhe rekomandimet përkatëse të lëna nga grupi i vlerësimit të jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e Institucionit në kuadër të këtij procesi;
- g. Raportin e ASCAL në lidhje me rezultatet e vlerësimit të jashtëm dhe faktin që ky Institucion nuk i është nënshtruar dhe nuk ka aplikuar ndonjëherë për vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit institucional;

**konstaton se:**

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në Kontratën MAS-QAA për këtë proces;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimin e Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në Institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet: pikat e forta, pikat e dobëta dhe afirmimet e identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në Institucion;
- e. Rekomandimet e lëna janë në koherencë me gjetjet si dhe shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë për Institucionin në fjalë;
- f. Rezultatet e vlerësimit të Jashtëm në lidhje me shkallën e plotësimit të Standardeve Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë sipas fushave janë: Fusha 1 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 2 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 3 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 4 “**përmbushen kryesisht**”, Fusha 5 “**përmbushen plotësisht**”, ndërsa rezultati i përgjithshëm “**përmbushen plotësisht**”;
- g. Vlerësimi përfundimtar i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për cilësinë akademike për këtë Institucion është Pozitiv me rekomandime;












*Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,*

## VENDOSI:

1. **Vlerësimin Përfundimtar POZITIV** për Institucionin e Arsimit të Lartë **Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**, me rekomandimet sipas Shtojcës së këtij Vendimi.
2. **Akreditimin Institucional** të Institucionit të Arsimit të Lartë, **Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë** me kohëzgjatjen prej **5 (pesë)** vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të Institucionit është **30/09/2022**.
3. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij Vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda 14 ditëve nga zbardhja e këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas Shtojcës bashkëlidhur.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

### BORDI I AKREDITIMIT

ARJAN GJONÇA		Kryetar
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
FABRICE HENARD		Anëtar
ARBEN MERKOCI		Anëtar
ALEKSANDËR XHUVANI		Anëtar
ANILA PAPARISTO		Anëtar
SULO HADËRI		Anëtar
LULJETA MINXHOZI		Anëtar
MYFTAR BARBULLUSHI		Anëtar
ILIR PANDA		Anëtar
FATMIR GURI		Anëtar

## Shtojca

### **Rekomandime**

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë duhet të ndjekë përmbushjen e rekomandimit të mëposhtëm të identifikuar nga ekspertët e grupit të vlerësimit, si vijon:

**Universiteti duhet të hartojë dhe zbatojë një strategji në mbështetje të zhvillimit sistematik të fushave të kërkimit të identifikuara si prioritare në Planin e tij të Zhvillimit Strategjik.**

Brenda vitit akademik 2017-2018, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë duhet të paraqesë në ASCAL një raport dhe dokumentacionin mbështetës mbi përmbushjen e këtij rekomandimi.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtij rekomandimi dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

